



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**ZL.Anr.767/2017**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesa e Fatir Barzik, nga radhët e subjektit politik Jedinstvena Goranska Partija, me seli në Dragash, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor në ditën e votimit, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më 12.11.2017, mori këtë:

### **V E N D I M**

**Hudhet si e pasafatshme** ankesa e Fatir Barzik, nga radhët e subjektit politik Jedinstvena Goranska Partija, me seli në Dragash me shenjën ZL.Anr.767/2017 e datës 09.11.2017, për shkak të parregullsive gjatë procesit të votimit me datë 22.10.2017.

### **A r s y e t i m**

PZAP, më datë 09.11.2017, ka pranuar ankesën nga Fatir Barzik, nga radhët e subjektit politik Jedinstvena Goranska Partija, me seli në Dragash, me të cilën pretendon se në emër të JGP-së kërkoj rinumërimin e votave në vendvotimet në pjesën ku është shumica e banuar me komunitet goran në komunën e Dragashit, për shkak të dyshimeve në parregullsi gjatë ditës së zgjedhjeve. Nga këto arsye kërkojnë rinumërim të votave e të gjitha kutive në vendvotimet me shumice gorane si:

0501A/02D, 0501X/02D, 0501X/01R, 0502A/01R, 0502A/02R, 0502A/03D, 0503A/06D, 0503A/01R, 0503A/04R, 0503A/05R, 0503A/03R, 0503A/02, 0504A/01R, 0504A/02D, 0505A/01R, 0505A/02D, 0514A/01D, 0517A/01D, 0520A/01D, 0521A/02D, 0521A/01R, 0525A/01D, 0527A/01D, 0529A, 01530A/01D, 0531A/02D, 0532A/01D

Poashtu i kontestojë edhe votat e ardhur përmes postes nga Maqedonia, dhe kërkojnë rinumërimin e tyre.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të afatshmërisë së ankesës, gjeti se:

**Apeli është i pasafatshme.**

Për të gjitha parregullsitë që mund të paraqiten në ditën e votimit, ankesa mund të paraqitet në PZAP, brenda 24 orëve nga momenti i mbylljes së Qendrës së Votimit, sipas nenit 119 të LZP-së lidhur me nenin 5 paragrafi 5.3 i Rregullës Nr.02/2015. Në rastin konkret ashtu siç

del nga ankesa, e njëjta është pranuar nga PZAP me datën 09.11.2017. Nga përmbajtja e ankesës rezulton se të gjitha pretendimet ankimore të parashtruara nga ankuesi në ankesën ZL.Anr.767/2017 të datës 09.11.2017, ndërlidhet me parregullsitë gjatë procesit të votimit, për ditën e votimit të datës 22.10.2017.

Nga kjo rezulton se ankesa e lartpërmendur është dorëzuar, pasi që ka kaluar afati ligjor për të parashtruar ankesë në PZAP, për parregullsitë në ditën e votimit sipas dispozitës së lartcekur ligjore, kjo nga fakti se afati për paraqitjen e ankesave ka qenë me datën 23.10.2017 deri në ora 19:00, ndërkaq ankuesi ankesën e ka parashtruar me datë 09.11.2017 në PZAP, që do të thotë se ankesa është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me nenin 5 paragrafi 5.3, lidhur me nenin 6 par.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015.

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë ne kuptim të nenit 118 dhe 119 të LZP-së dhe nenin 5 par. 5.3, neni 6 par.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.767/2017 më datën 12.11.2017



**Kryesuesi i Panelit**  
**Gyltene Sylejmani**

**Këshillë Juridike:** PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.